



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM  
PËR ÇELJEN E GARËS PËR DHËNIEN E 1 (NJË) LICENCE TRANSMETIMI  
AUDIO ANALOGE**

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënie të licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 153, datë 18.07.2016, i ndryshuar, si dhe vendimit të AMA-s, nr. 84, datë 07.06.2019 “Për çeljen e garës për dhënie të licencës private të transmetimit audio analoge dhe miratimin e dokumentacionit të licencimit” do të organizojë procedurën e përzgjedhjes së kandidatave për dhënie të 1 (një) licence private transmetimi audio analoge, të përbërë nga:

- licenca e shërbimit të programi audio;
- licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit analog.

Për zonën e mëposhtme:

Nr	Zona e ofrimit të shërbimit	Përcaktimi i operatorit	Pika e transmetimit	Frekuenca (MHz)
1.	Qarqet Tiranë dhe Durrës	Audio analoge rajonale	Fushë Dajt Krujë	89 93.8

Subjektet e interesuara për t’u pajisur me licencë private transmetimi audio analoge, janë të lutur që të depozitojnë aplikimet në Autoritetin e Mediave Audiovizive, rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 15, Kutia Postare 1010, Tiranë, **brenda datës 28 gusht 2019, ora 10.00.**

Dokumentacioni i plotë i konkurrimit të kandidatave, që përfshin:

- Rregulloren “Për procedurat dhe kriteret për dhënie të licencës së transmetimit audio” e ndryshuar;
- Kushtet teknike të instalimit të pajisjeve transmetuese për secilën zonë të shpallur; (Pika e transmetimit, kanali, fuqia e transmetuesit);
- Kërkesat programore;
- Pagesat për licencën, taksat etj, të llogaritura për zonën në fjalë;

mund të tërhiqet në zyrën e Arkivë-Protokollit, në AMA pas kryerjes së pagesës në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, nga çdo subjekt që synon të marrë pjesë në konkurrim.

Aplikimet do të hapen **në datën 28 gusht 2019, ora 10.00, në mjediset e AMA-s**, ku subjektet aplikues apo përfaqësuesit e autorizuar prej tyre, kanë të drejtë të jenë të pranishëm në momentin e hapjes së dosjeve të aplikimit.